



BACHELOR

PLANIFIKIM DHE ARKITEKTURË PEIZAZHI

NË BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN BOKU

Pse ky program studimi?

Ky program studimi është krijuar si përgjigje ndaj nevojës në rritje për specialistë që kuptojnë territorin si sistem ekologjik, social dhe estetik.

Ai adreson sfidat e urbanizimit të shpejtë, degradimit të peizazhit, ndryshimeve klimatike dhe nevojës për infrastrukturë të gjelbër, duke lidhur formimin akademik me kërkesat reale të tregut të punës në Shqipëri.


Programi synon të formojë specialistë të aftë për të analizuar, planifikuar, projektuar dhe menaxhuar peizazhe urbane, rurale dhe natyrore në shkallë të ndryshme. Objektivat kryesore janë forcimi i bazës teorike dhe ekologjike, zhvillimi i aftësive projektuese e digjitale, integrimi i dimensioneve sociale, ligjore dhe ekonomike në vendimmarrje, si dhe përgatitja e studentëve për punë profesionale dhe studime Master.

Diplomë që njihet ndërkombëtarisht



Përshkrimi i programit

Programi Bachelor në "Planifikim dhe Arkitekturë Peizazhi" është një program ndërdisiplinor që kombinon bazat ekologjike dhe territoriale me planifikimin hapësinor, projektimin e peizazhit dhe menaxhimin e ndërhyrjeve në terren. Kurrikula zhvillohet në 6 semestra dhe ndërton gradualisht kompetenca në analizë, planifikim, projektim, përfaqësim grafik, përdorim të GIS/CAD, komunikim profesional dhe praktikë në situata reale. Programi mbështetet në reformën UBT-BOKU 2030, në përvojën ekzistuese të UBT-së në arkitekturën e peizazhit dhe në një qasje të orientuar drejt standardeve evropiane, praktikës profesionale dhe vijimit të studimeve në ciklin e dytë.



Profili i të diplomuarit / Profil profesional


- **Specialist i planifikimit të peizazhit dhe territorit**, në bashki, agjenci planifikimi, projekte zhvillimi vendor e rajonal,
- **Projektues i hapësirave dhe arkitekturës së peizazhit**, në studio projektimi, kompani ndërtimi, projekte urbane
- **Specialist për konservim natyre dhe menaxhim peizazhi** në plane menaxhimi për zona të mbrojtura, projekte restaurimi, zhvillim të turizmit të qëndrueshëm
- **Specialist i analizës hapësinore dhe komunikimit teknik** në institucione publike, studio private, organizata zhvillimi dhe projekte



Anisa Shinko

Arkitekthe Peizazhi "S&L Studio"

"Studimet në këtë degë kanë ndikuar ndjeshëm në formimin tim profesional. Aktualisht punoj si arkitekthe peizazhi, duke u angazhuar në projekte për projektimin e hapësirave të jashtme dhe integrimin e natyrës në mjedise urbane."



Ndue Lleshaj

Arkitekt Peizazhi, "SON Architect +"

"Zhvillimi i shpejtë urban e bën arkitekturën e peizazhit gjithnjë e më të rëndësishme në krijimin e hapësirave të qëndrueshme. Studimet në Universitetin Bujqësor të Tiranës më dhanë bazën për të zhvilluar profesionin tim në një nga studiot më të mëdha të arkitekturës në vend."



Klea Cakoni

Arkitekthe Peizazhi "Lita Construction" sh.p.k

"Arkitekti i peizazhit luan një rol të rëndësishëm në organizimin e hapësirave të jashtme në zhvillimet rezidenciale, duke krijuar lidhje të qëndrueshme mes ndërtimit dhe natyrës. Përmes projektimit të mirëorganizuar, ai ndikon në cilësinë e jetesës dhe në vlerën afatgjatë të këtyre zhvillimeve."



Esma Zeneli

Arkitekthe Peizazhi "UNS architects"

"Arkitektura e peizazhit ndërthur artin dhe natyrën për hapësira funksionale dhe të bukura, që ofrojnë relaks, aktivitete sociale dhe lidhje me natyrën, duke mbështetur edhe qëndrueshmërinë dhe biodiversitetin."

Kompetencat kryesore të fituara

Në përfundim të programit, studentët fitojnë kompetenca në:

- Analizë dhe vlerësim të peizazhit,
- Planifikim territorial
- Projektim të hapësirave, përdorim të GIS dhe CAD, komunikim grafik dhe profesional
- Menaxhim bazë të proceseve të zbatimit.
- Aftësi për punë në grup, mendim kritik, ndërveprim me aktorët dhe veprim profesional me përgjegjësi etike, mjedisore dhe sociale.

PËRMBAJTJA E STUDIMEVE

LËNDËT BAZË

Ekologji,
Gjeoshkenca,
Statistika,
Topografi

LËNDËT KARAKTERIZUESE

Teori e metoda të peizazhit,
Legjislacion,
Planifikim hapësinor
Konservim natyre

TË TJERA

Projektim, bimë në peizazh,
turizëm rural dhe ndërtime në
peizazh;
paraqitje grafike dhe gjuhë
angleze; si dhe praktikë
profesionale e temë diplome.

Mësimdhënia zhvillohet përmes leksioneve, seminareve, studiove të projektimit, ushtrimeve praktike, punës në terren dhe përdorimit të mjeteve digjitale. Format i të nxënësve është i orientuar nga projekti, bashkëpunimi në grup, analiza e rasteve reale dhe prezantimi publik i punimeve, duke kombinuar përvetësimin teorik me aftësitë zbatuese dhe reflektimin kritik.

Mundësi Punësimi:

- Bashki dhe njësi të qeverisjes vendore,
- Agjenci planifikimi e mjedisi,
- Struktura të menaxhimit të zonave të mbrojtura,
- Studio projektimi, kompani ndërtimi,
- Projekte zhvillimi rural, turizëm të qëndrueshëm
- Organizata që punojnë me peizazhin, biodiversitetin dhe territorin.

Të dhënat e programit

Niveli i studimit

Cikli i parë, Bachelor

Titulli akademik

Bachelor në "Planifikim dhe Arkitekturë Peizazhi"

Kohëzgjatja

3 vite akademike / 6 semestra

Kredite

180 ECTS

Forma e studimit

Me kohë të plotë

Gjuha e studimit

Shqip / Anglisht

Kuota studimi

50 studentë

Përfundimi i studimeve

Provim formimi / Temë diplome



Rreth UBT

Universiteti Bujqësor i Tiranës u themelua më 1 nëntor 1951 dhe prej vitit 1956 është vendosur në Kodër Kamëz. Që nga krijimi, ai ka qenë një shtyllë e arsimit dhe kërkimit bujqësor në Shqipëri.

Sot, UBT luan një rol kyç në bujqësinë e qëndrueshme, sigurinë ushqimore dhe zhvillimin rural, duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar përmes partneriteteve strategjike, përfshirë Universitetin BOKU të Vjenës.



Për më shumë informacion vizitoni:

www.ubt.edu.al

info@ubt.edu.al

Rruga "Pajsi Vodica" Tiranë

MUNDËSI VAZHDIMI STUDIMESH (MASTER)

Programi krijon bazën e nevojshme për vijimin e studimeve në ciklin e dytë, veçanërisht në programe Master në Planifikim dhe Arkitekturë Peizazhi, planifikim territorial, mjedis, menaxhim të burimeve natyrore dhe fusha të afërta ndërdisiplinore. Formimi i balancuar në shkenca natyrore, projektim, instrumente ligjore dhe mjete digjitale u jep të diplomuarve mundësi të zhvillojnë më tej profilin akademik dhe profesional.

FOLLOW US ON SOCIAL MEDIA



Agricultural University of Tirana



universiteti_bujqesor_tiranes
fbm_ubt



Universiteti Bujqësor i Tiranës - Faqja Zyrtare
Fakulteti I Bujqësisë dhe Mjedisit- Faqja Zyrtare

Për jetën dhe të ardhmen...